

Eduart CAKA

NGA MËRGATA NË DIASPORË: SHQIPTARËT E EGJIPTIT DHE DIASPORA SHQIPTARE NË AMERIKË

Abstrakt:

Prania e shqiptarëve në Egjipt përfshin një hark kohor prej disa shekujsh, i cili konsiston kryesisht me aktivitetin e pashallarëve dhe komandantëve shqiptarë fillimisht si qeveritarë në këtë gjeografi, gjatë periudhës së sundimit osman për të arritur kulmin gjatë kohës kur këtë vend e drejtoi Mehmed Aliu dhe pasardhësit e tij, duke nisur nga fillimet e shek. XIX. Pikërisht në këtë shekull zë fill edhe zgjimi kombëtar i faktorit shqiptar në pjesë të ndryshme të Perandorisë Osmane, por edhe nis formësimi i diasporës shqiptare në Amerikë. Në këtë kumtesë do të përpiqemi të trajtojmë ndikimin që pati mërgata shqiptare e Egjiptit në formësimin e diasporës së shqiptarëve të Amerikës gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare dhe epokës së Pavarësisë.

Fjalë kyçe: Egjipti, Amerika, emigrimi, shqiptarët, diaspora.

Egjipti si botë e ndërmjetme mes shqiptarëve, osmanëve dhe të tjerëve

Njëri prej shkaqeve që e bënte Egjiptin tërheqës për të gjithë, përfshirë këtu edhe shqiptarët, kishte të bënte me elementin historik, pra atë që përfaqësonte në vetvete ky vend, i cili është njëri prej qytetërimeve më të mëdha që ka shënuar historia e njeriut.

Madje, sikurse evidenton edhe Hathaway, në një hapësirë kaq shumë turbulente sikurse ishte Lindja e Mesme dhe pjesa e Afrikës Veriore, Egjipti kishte qenë i vetmi shtet që mundi ta ruajë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandryshuar integritetin e vet territorial¹, aspekt i cili nxjerr në pah peshën e madhe që kishte ky vend pavarësisht kohës apo ngjarjeve që e karakterizuan këtë gjeografi. Për këtë arsye, vendosja në këtë gjeografi si qeverisës, duket se ishte njëri prej aspekteve kryesore që e joshte krenarinë e njeriut, në rastin tonë, të pashallarëve me origjinë shqiptare, të cilët qeverisën këtu kryesisht gjatë shek. XVI-XVII dhe XIX deri në gjysmën e shek. XX.²

¹ Jane Hathaway, *The Arab Lands under Ottoman Rule, 1516-1800*, New York: Routledge, 2008, f. 24.

² Muhamed Mufaku, *Nga historia e shqiptarëve të Egjiptit gjatë shekujve XV-XX*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë: 2016, f. 17-19; Eduart Caka, "Mbi praninë e

Elementi i dytë, është ai hapësinor, ku si një gjeografi e pamasë, Egjipti i jepte mundësinë njeriut të sundojë mbi një terren tejet të zgjeruar. Qytetet këtu qenë të organizuara në kala të vogla, ndërsa pjesa tjetër ishte shkretëtirë, ku sundonte anarkia, klanet fisnore e barbaria. Prandaj, qeveritarët e këtushëm duhej të ishin njerëz të ashpër, që e kishin për zemër luftën dhe që nuk ngurronin të përdornin secilin mjet të dhunës për të vendosur rendin. Për më tepër, pozita gjeografike e Egjiptit, jo vetëm që hapej drejtpërsëdrejti me botën mesdhetare, po gjithashtu e lidhte atë edhe me kontinentin afrikan dhe gadishullin arabik, duke e bërë këtë hapësirë tejet strategjike në aspektin e lëvizshmërisë. Elementi i tretë, ishte ai ekonomik, ku Egjipti përbënte edhe ejaletin më të pasur të Perandorisë Osmane, duke i sjellë asaj pjesën më të madhe të të hollave që hynin në thesarin e shtetit. Pikërisht ky aspekt, pra shfrytëzimi i këtyre resurseve për të arritur pasurim të shpejtë, bënte që njerëzit të vinin këtu. Ky qe edhe njëri prej shkaqeve që shqiptarët mbërritën në vendin e faraonëve, ku, sipas Thimi Mitkos, duke ndjekur nga pas ushtarët që vinin këtu, edhe korçarët që merreshin me tregti mbërritën këtu aty në kapërcyell të shek. XIX.³ Veçanërisht vendosja e anglezëve këtu gjatë këtij shekulli dhe aktiviteti ekonomik, infrastrukturor e tregtar, që ata ndërmorën këtu, e bëri edhe më tërheqës Egjiptin në aspektin e gjenerimit të të ardhurave për ata që vinin si emigrantë për të punuar.

Aspekti i katërt ka të bëjë me pushtetin politik, ku pashai i Egjiptit në hierarkinë osmane kishte një vend të veçantë. Madje, në dekadat e para të vendosjes së sundimit osman më këtë hapësirë, pashai i këtij ejaleti, cilësohej me titullin e sulltanit.⁴ Ndoshta ishin të gjithë këta elementë bashkë, të cilët ndikuan që osmanët t'i jepnin një rëndësi të veçantë sjelljes së shqiptarëve si qeveritarë dhe ushtarakë në këtë gjeografi, ku më shumë se aftësitë drejtuese të administratorit, më shumë nevojitej guximi dhe aftësia në aspektin ushtarak në kontrollimin e një gjeografie të gjerë në kontekstin hapësinor, por edhe të një popullsie të vështirë për t'u kontrolluar në këndvështrimin e ruajtjes së rendit.

shqiptarëve dhe rolin e tyre në vendosjen e sundimit Osman në Egjipt gjatë gjysmës së parë të shek. 16", *Ura*, nr. 18 (2022), fq. 20-35. J. Hathaway, *The Arab Lands...*, f. 225.

³ Thimi Mitko, *Bleta shqiptare. Shkrime të tjera dhe dokumente*, vëll. A, përg. Dhori Q. Qirjazi, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2020, f. 43.

⁴ Edhe veziri Ahmed Pasha kur u rebelua në Egjipt në vitin 1524, e shpalli veten sulltan. Për më shumë, shih E. Caka, *Mbi praninë e shqiptarëve*, f. 27-27; Halil Inalcık, *Devlet-i Aliyye, Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, I, İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yay., 2016, f. 144.

Panorama do të ndryshojë në fundin e shek. XVIII dhe fillimin e shek. XIX kur kjo gjeografi u përfshi fillimisht në luftë si rrjedhojë e fushatës ushtarake që Napoleon Bonaparti ndërmoi këtu gjatë viteve 1798-1801, ku për mbrojtjen e kësaj gjeografie osmanët dërguan regjimente të shumta, në mesin e të cilëve bënte pjesë edhe Muhamed Aliu nga Kavalla, i cili do të ishte edhe sundimtari i parë i Egjiptit pasoman. Është gjithashtu interesant fakti se, si rrjedhojë e përplasjeve të Muhamed Aliut me Portën e Lartë, kjo e fundit do të përpiquej të rekrutojë ushtarë, përfshi këtu edhe ato nga zona e Toskërisë, për t'i dërguar në front drejt Egjiptit.⁵ Periudha e sundimit të Mehmed Aliut në Egjipt solli me vete edhe një prezencë të shtuar të shqiptarëve këtu, të cilët vinin për të punuar ose për t'u inkuadruar në trupat ushtarake që i shërbenin këtij sundimtari shqiptar. Domosdoshmërisht, kjo ekzistencë e theksuar e faktorit politik shqiptar në Egjipt, sillte me vete edhe interesimin e këtushëm ndaj zhvillimeve që ndodhnin në hapësirat shqiptare veçanërisht gjatë kohës së Kongresit të Berlinit dhe Lidhjes së Prizrenit. Kështu, ngjarjet e terrenit do të jenë vazhdimisht të pasqyruara në shtypin egjiptian.⁶

Sipas diplomatëve austro-hungarezë, në Vatikan mësojmë se kishte edhe klerikë të dioqezave shqiptare, të cilët qenë dërguar për të shërbyer në Misionet e Egjiptit.⁷ Kryesisht bëhet fjalë për klerikë të urdhrin françeskan që erdhën këtu dhe krijuan kontakte me shqiptarë që jetonin në Egjipt e më gjerë. Ndonëse komuniteti katolik këtu ishte i vogël në numër, shumë më i madh ishte ai ortodoks, të cilët kishin emigruar kryesisht prej zonave të Shqipërisë Juglindore dhe ushtronin aktivitetin e tyre, tregtar në shumicë, në Egjipt.⁸ Kodiku i Korçës dhe Selasforit⁹ na jep informacione të shumta e të detajuara mbi një numër të madh individësh të këtyre zonave që kishin shkuar për të jetuar e punuar në Egjipt, por që në testamentet e tyre linin pasuri të ndryshme për vendlindjen, që kishin financuar këtu objekte të ndryshme bamirësie, ose që vendosnin të ktheheshin pas vitesh të gjata emigrimi. Një kategori tjetër

⁵ *Kryengritjet popullore në vitet 30 të shekullit XIX (dokumente osmane)*, përg. Petrika Thëngjilli, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1978, f. 45.

⁶ Muhamed Mufaku, *Figura shqiptare në Lindjen e Mesme (shek. XVI-XX)*, Shkup: Logos-A, 2021, f. 85.

⁷ *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (dhjetor 1879-qershor 1880)*, vëll. III, përg. Beqir Meta, Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri", 2018, f. 709.

⁸ Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, përkth. Skënder Luarasi, Nestor Nepravishta, Tiranë: Phoenix, 2000, f. 146.

⁹ *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit. Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII-fillimi i shek. XX*, përgatitur për botim nga Petraq Pepo, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Qendra e Botimeve Enciklopedike, 2018.

religjioze shqiptarësh që gjeti “strehim” në Egjipt, ishin edhe bektashinjtë. Dervishë të shumtë, kryesisht nga zonat jugore e juglindore të Shqipërisë vërejmë të kenë emigruar në drejtim të Misirit, duke formuar këtu një rrymë të fuqishme të këtij urdhri, ku më pas këta dervishë do të ktheheshin për të shërbyer në vendlindjen e tyre apo në vende të tjera ku gjendeshin pjesëtarët e këtij sektit. Një personalitet i rëndësishëm që shërbeu këtu, duke i hapur rrugën edhe mbërritjes së dervishëve të tjerë në këtë vend, ishte Ahmed Sirri Baba, i cili la pas edhe shkrime të rëndësishme për prezencën e bektashizmit në Egjipt kryesisht për shekujt XIX-XX.¹⁰

Egjipti si “zonë strehimi”

Veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, periudhë e cila përkon edhe me Rilindjen Kombëtare Shqiptare, hapësira e Egjiptit luajti një rol tejet domethënës e me peshë në veprimtarinë politike, ekonomike e kulturore të faktorit shqiptar të kohës. Kjo, në vetvete, mund të shpjegohet me disa faktorë të rëndësishëm që kishin të bënin me gjendjen ekzistuese politiko-ekonomike të Egjiptit, por edhe me përqendrimin e shqiptarëve në këtë vend. Për ta shtjelluar argumentin, vlen të theksohet se Egjipti nuk ishte pjesë e Perandorisë Osmane; se drejtohej prej një dinastie me prejardhje shqiptare, dhe; veçanërisht me vendosjen këtu të anglezëve krijonte kushte të favorshme ekonomike, por bënte të mundur lidhjen e këtij vendi me një rrjet më të gjerë vendesh. Kjo, nëse do të kemi parasysh shtrirjen dhe influencën që arriti Britania në shek. XIX.

Pozicioni gjeografik, avantazhet ekonomike e politike dhe liria që gjetën këtu shqiptarët, jo vetëm që e bënë tejet aktive Lëvizjen Kombëtare këtu, por krijonin kushte për mobilitet dhe ndërveprim edhe me shoqëritë e tjera që gjendeshin në pjesë të ndryshme të perandorisë ku vepronin shoqëritë shqiptare. Një rast i ngjashëm ishte ai i Nikola Laços nga Korça, i cili kishte qenë pjesë e Lëvizjes në Egjipt dhe do të emigronte drejt Rumanisë në vitin 1884 për t’u anëtarësuar në shoqërinë Drita.¹¹ Pikërisht një tablo e tillë na e bën më të lehtë ta kuptojmë shkaku e emigrimit të shumë figurave shqiptare të Rilindjes Kombëtare në Egjipt. Ata mund të gjenin strehim politik në rastet kur përplaseshin me sulltanin, të siguronin mbështetje ekonomike për

¹⁰ Për më shumë rreth teqeve kryesore të Kajros e Egjiptit, prezencën e shqiptarëve këtu dhe aktivitetin e Ahmet Sirri Babait, shih Salih Çift, *Mısır’da Bektaşilik*, İstanbul: Dergah Yayınları, 2013.

¹¹ S. Skendi, *Zgjidhja kombëtare shqiptare*, f. 143.

çështjen kombëtare apo edhe ta përdornin këtë destinacion si një objektiv për t'u hedhur në ndonjë gjeografi tjetër sikurse do të jetë Bota e Re, pra Amerika. Sikurse e konstaton me të drejtë Skendi, Egjipti ofronte një realitet shumë më kozmopolit veçanërisht për intelektualët, politikanët dhe aktivistët e çështjes shqiptare gjatë kësaj kohe.¹² Kështu mund të shpjegohet edhe fakti se disa prej figurave kryesore politike e kulturore shqiptare të shek. XIX-XX mbërritën në Egjipt, qoftë edhe për një hark kohor të shkurtër. Njëri prej emrave të mëdhenj të elitës shqiptare të kohës që e vizitoi Egjiptin, ishte edhe Ismail Qemali. Ndonëse në vitet 1901 ai e vizitonte këtë vend i ftuar prej kolonisë shqiptare të këtushme si një shtetar osman, në vizitën e dytë thuajse një dekadë më vonë, përkatësisht më 1910, ai u prezantua në shtypin dhe opinionin vendas si opozitar i absolutizmit të sulltanit.¹³

Fan Noli erdhi në Egjipt në vitin 1903, ku qëndroi duke punuar si mësues i gjuhës greke për një periudhë tre vjeçare, për të emigruar më vonë drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku kaloi pjesën më të madhe të jetës. Në këtë vendim të tijin ndikuan veçanërisht këshillat e Jani Vruhos dhe Thanas Tashkos¹⁴, të cilët e kuptonin tanimë rolin e madh që Amerika luante në gjeopolitikën e reja globale. Ndër shqiptarët e njohur të kohës që pati përplasje të ngjashme dhe u detyrua të emigrojë drejt Egjiptit, ishte edhe Said Halim Pasha, nip i valiut të Egjiptit, Mehmet Ali Pashës. Krahas spikatjes së tij në profilin e politikanit, Said Halimi u dallua gjithashtu edhe në fushën e mendimit, duke shkruar një sërë librash që përfshinin fushat e politikës, sociologjisë, religjionit etj. Gjatë kohës së ngritjes së xhonturqve, duke përdorur faktin e afërsisë së tij me ta, Said Halim Pashën do ta dëbonin nga Stambolli, ku u detyrua fillimisht të emigrojë drejt Egjiptit e më pas edhe në Europë.¹⁵ Si rrjedhojë e pozicionimit politik, por edhe për arsye shëndetësore, që nga viti 1923 Mehmet Akif Ersoj do të largohej në drejtim të Egjiptit, ku edhe kaloi një pjesë të madhe të jetës së tij.¹⁶ Me origjinë nga Shushica e Pejës

¹² Për më shumë detaje mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare të Egjiptit dhe aktivitetin e tyre, shih S. Skendi, *Zgjidhje kombëtar shqiptar*, f. 146-147.

¹³ M. Mufaku, *Figura shqiptare në Lindjen e Mesme...*, f. 87-88.

¹⁴ Beqir Meta, Erjon Dervishi, Hasan Bello, *Vatra dhe shqiptarët në Amerikë, 1912-1990*, Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri", 2022, f. 23-24.

¹⁵ Për jetën dhe aktivitetin politik e intelektual të Said Halim Pashës, shih M. Hanefi Bostan, "Said halim Pasha", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXXV, İstanbul: TDV Yay., 2008, f. 557-560.

¹⁶ M. Orhan Okay, M. Ertuğrul Düzdağ, "Mehmed Âkif Ersoy", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXVIII, Ankara: TDV Yay., 2003, f. 432-439; Eduart Caka, "Një shqiptar në shërbim të njerëzimit", *Zani i Naltë*, nr. 4 (2013), f. 88-98.

dhe me një kontribut të theksuar veçanërisht në fushën e letrave, Mehmed Akifi ka hyrë më së shumti në histori si njeriu që shkroi himnin e flamurit të Turqisë. Ndonëse e shpreh qartë përkatësinë e tij shqiptare dhe e shpreh përmes vargjeve dhimbjen e tij për ditët e vështira që kalonte Shqipëria dhe shqiptarët në veprën e tij madhore, *Safahat*, që përbëhet prej 11.240 strofash, si shumë intelektualë të tjerë shqiptarë të kohës, edhe ai zgjodhi ta kalojë jetën në Turqi edhe pas shpalljes së Pavarësisë. Një element tjetër që vlen të theksohet në këtë kontekst, është edhe kontakti, lidhjet dhe marrëdhëniet e personaliteteve publike të kohës, të cilët i jepnin rëndësi elementit etnik për të mbrojtur apo mbështetur njëri-tjetrin. Një shembull veçanërisht ilustrues në këtë aspekt, është marrëdhënia e Mehmed Akif Ersojit me pinjollët e dinastisë së Muhammed Aliut në Egjipt. Kryesisht për arsye politike, ai u detyrua të emigrojë në drejtim të Kajros, zhvendosje e cila qe bërë e mundur me ftesën që i solli Abbas Halim Pasha, i biri i Halim Pashës që qe edhe djali i katërt i Muhamed Aliut. Edhe nipi tjetër i kreut të dinastisë shqiptare që sundoi Egjiptin, Said Halimi për të cilin u shkrua më lart, iu gjend ekonomikisht Mehmed Akifit duke i propozuar që të përkthejë disa prej veprave të veta në frëngjisht.¹⁷

Egjipti si vend i mundësive dhe i të ardhurave

Pjesa më e madhe e banorëve të Korçës, kryesisht të asaj hapësire që njihej si Varoshi i Korçës, që emigruan në drejtim të Egjiptit u vendosën në qendra të rëndësishme ekonomike e kulturore si Kajro, Aleksandri, Beni Suef, Mansura, Manflut etj., ku ushtronin kryesisht mjeshtëri që kishin të bënin me fushën e përpunimit të tekstileve.

Përkatësisht profesionin e terziut, pra të rrobaqepësit, ku një grup qenë pozicionuar në lagjen Xhuvania.¹⁸ Ajo çka mund të thuhet me siguri për rastin e Egjiptit, ka të bëjë me faktin se ky vend ofronte më shumë liri për shqiptarët, si në aspektin politik ku ata përfitonin prej faktit se hapësira në fjalë qeverisej prej Mehmed Aliut, por edhe për mundësitë e mëdha që ofronte në aspektin ekonomik. Për këtë arsye, shqiptarët që erdhën këtu u integruan dhe pasuruan shpejt krahasuar me të tjerë që u vendosën në vende të ndryshme ku kishte koloni shqiptare.

¹⁷ H. Bostan, *Said halim Pasha*, f. 557-560.

¹⁸ Sipas shënimeve të kodikut, pjesa kryesore e të krishterëve që kishin emigruar prej kësaj zone, merreshin me rrobaqepësi. Shih *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit...*, f. 84.

Një pjesë e tyre vendosën të jetojnë atje për të mos u kthyer më, por kishte të tillë që edhe ndërruan jetë pa u kthyer. Megjithatë, në testamentet e tyre dhe dhurimet që dërgonin, mësojmë se ata kanë kontribuar për qytetin e tyre në mënyrë të vazhdueshme.

Një dokument i vitit 1879, pjesë e kodikut të Korçës dhe Selasforit, përmban një listë të bamirësve të ndryshëm që kishin dërguar të holla për objektet fetare, shkollat apo elementë të tjerë infrastrukturorë të qytetit sikurse ishin çezmat, rrugët etj. Një pjesë e madhe e emrave të përmendur aty janë korçarë që jetonin në qytete të ndryshme të Egjiptit.¹⁹ Por, kishte edhe të tjerë që vendosën të kthehen në vendlindjen e tyre pas qëndrimit për vite në mërgim. I tillë ishte edhe rasti i Dhimitër Pilikës, i cili kishte punuar me vite në Egjipt, do të kthehej në Korçë aty rreth vitit 1874, ku edhe ndërtoi një hamam në këtë qytet²⁰, i dyti pas atij të Iljaz Bej Mirahorit.

Një zhvillim tjetër që ndikoi në vendosjen këtu të shqiptarëve për arsye ekonomike, ishte edhe vendosja e Anglisë në Egjipt në vitin 1882, zhvillim i cili i dha një shtysë të madhe industrializimit dhe modernizimit të këtij vendi. Këtë e mësojmë edhe nga një dokument i Dhjetorit të vitit 1882, ku mësojmë se shqiptarët që jetonin prej kohësh në Kajro, Aleksandri e qyteteve të tjera, u dërgonin telegrame të afërmve dhe banorëve në Durrës, që të vinin në Egjipt për arsye se anglezët kishin hapur vende të shumta pune. Për këtë, ata duhej të lidheshin me një shqiptar tjetër që jetonte në Korfuz, Hajredin Beun, që do t'u siguronte edhe mënyrën e udhëtimit në drejtim të Egjiptit.²¹

Këtë element e vërejmë qartësisht të dëshmuar edhe në kujtimet e Eqrem Bej Vlorës, i cili gjatë vizitës së tij në Kajro aty nga fundi i vitit 1911 flet për shqiptarë, që konsideroheshin si elitat e shoqërisë egjiptiane, të cilët gëzonin mbështetjen dhe përkrahjen e familjes që sundonte Egjiptin. Në përshkrimet e gjata të Eqremit mbi këtë vend të rëndësishëm e me histori të madhe, të bën përshtypje një takim i tij me dy personalitete, Nesip Efendiun nga Libohova që ishte kryekadi i Egjiptit dhe doktor Turtullin, një ortodoks korçar që ishte mjek i familjes së Kedivit, pra sundimtarit të Egjiptit, pinjoll i Muhamed Aliut.²²

¹⁹ *Kodiku i Korçës dhe i Selasforit...*, f. 287-288.

²⁰ Po aty, f. 344.

²¹ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien (HSt.A.P.A.A)* në *Arkivin e Institutit të Historisë-Tiranë (AIH)*, Vj. 32-1-107.

²² Eqrem Bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, Përkth. Afrim Koçi, Tiranë: Botimet IDK, 2010, f. 256-257.

Mërgata e Egjiptit dhe kontributi i tyre në formësimin e diasporës shqiptare në Amerikë

Në gazetatat që botoheshin prej kolonive shqiptare të Amerikës gjatë viteve 1910-1920, numri i popullsisë shqiptare që jetonin në këtë shtet përlogaritej në shifrat e 40 000 personave.²³ Ndërsa në fundin e viteve 1980 ky numër arrinte në shifrat e 70 mijë të tillëve²⁴, shifra të cilat tregojnë një rritje të vazhdueshme të njerëzve me origjinë shqiptare që jetonin përtej Atlantikut.

Këta individë kishin udhëtuar përtej oqeanit duke u nisur si nga trojet shqiptare, ashtu edhe nga pjesë të tjera të Perandorisë Osmane ku jetonin shqiptarët, por edhe prej shteteve të ndryshme të Europës dhe Ballkanit. Sa i përket vendit të tyre të origjinës, ajo çka theksohet në lidhje me brezat e parë të shqiptarëve që mbërritën në Amerikë, pjesa kryesore e tyre vinin prej Korçës, të cilëve më vonë iu shtuan edhe të tjerë prej hapësirave jugore shqiptare.²⁵ Sigurisht që një pjesë e konsiderueshme e këtyre njerëzve vinin edhe prej Egjiptit, emigracioni duket se ka vijuar deri në gjysmën e shek. XX. Përkatësisht, deri në rrëzimin nga fronti të Fuadit II, pinjollit i fundit i dinastisë së Mehmed Ali Pashës që e qeverisi këtë vend.

Nuk e kemi të mundur të nxjerrim saktësisht një numër të përafërt të atyre shqiptarëve që emigruan nga Egjipti në drejtim të Amerikës, pasi studimet e thelluara në lidhje me këtë çështje ende mungojnë. Një element tjetër që e pengon nxjerrjen e një të dhëne sa më të saktë, ka të bëjë edhe me faktin se për arsye pragmatiste, sikurse mund të ishte regjistrimi si pjesëtar i një etnie apo shteti tjetër, individë të ndryshëm nuk janë regjistruar si shqiptarë kur janë nisur prej Egjiptit apo kur kanë mbërritur në Shtetet e Bashkuara. Veçanërisht para periudhës së shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar, shqiptarët në Egjipt zgjidhnin përkatësi të tjera përveç asaj osmane, pasi kjo gjë u krijonte atyre lehtësira që vinin si rrjedhojë e kapitulacioneve që iu njiheshin këtyre shteteve. Një rast i tillë, është ai i Konstandin Toklit nga Korça, “shqiptar, bir shqiptari që vinte nga Varoshi i Korçës”, i cili kur emigroi në drejtim të Egjiptit kishte zgjedhur të mbajë shtetësinë greke për privilegjet që i siguronte ky veprim.²⁶

²³ *The Albanian Era*, vol. 1 (1915), f. 85.

²⁴ Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania, Second Edition*, Toronto: The Scarecrow Press, 2010, f. 461.

²⁵ S. Skendi, *Zgjidhimi kombëtar shqiptar*, f. 151.

²⁶ Në shënimet e kohës kuptohet se ky nuk ishte një rast i veçantë, por një praktikë e zakonshme. Për më shumë, shih *Kodiku i Korçës dhe i Selasfortit...*, f. 350. Ndërsa për testamentin e të ndjerit, me anë të së cilit i rrëfen vetë të gjitha këto, shih *Kodiku i Korçës dhe i Selasfortit...*, f.

Tek të dhënat e panjohura mbi numrin e saktë të popullsisë shqiptare që u vendos në ShBA vlen të përmendet edhe ajo kategori e madhe arbëreshësh që emigroi nga Italia në dekadat e para të shek. XX. Si rrjedhojë e shtetësisë që kishin, ndonëse me origjinë shqiptare, ata janë regjistruar si shtetas italianë në momentin e mbërritjes në kontinentin amerikan. Për rrjedhojë, të gjitha këto detaje na e vështirësojnë nxjerrjen e një numri të saktë të shqiptarëve të Amerikës gjatë gjysmës së parë të shek. XX e në vijim. Për t'u kthyer tek ajo pjesë e emigracionit shqiptar, që lëvizti nga Egjipti në drejtim të Shteteve të Bashkuara, ndonëse pa një statistikë të saktë, mund të thuhet se për nga tipologjia, ky emigrim përkonte në dy objektiva kryesore: ai ekonomik dhe tjetri, politik. Kjo e dyta veçanërisht do të marrë hov pas Luftës së Dytë Botërore.

Në kuadër të aktivitetit të Fan Nolit në Amerikë vlen të theksohet fakti se, sipas S. Skendit, ai u nis nga Egjipti fillimisht me qëllimin për të ardhur pranë një shoqërie shqiptare në Bufalo, të themeluar nga Petro Nini Luarasi e që quhej Malli i Mëmëdheut.²⁷ Ndërsa pjesa tjetër e aktivitetit të Nolit për komunitetin shqiptar të Amerikës, tanimë është e njohur. Njëri prej rasteve të përdorjes së Egjiptit për të kaluar në ShBA, ishte edhe ai i Baba Rexhepit, i cili erdhi këtu nga Shqipëria fill pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në vitin 1948.²⁸ Mirëpo me ndryshimet që ndodhën këtu në aspektin politik, ai do të detyrohej të largohet nga Egjipti, ku emigroi në drejtim të Amerikës dhe u vendos në Detroit, vend në të cilin hodhi edhe themelet e teqesë që vijon ende të jetë funksionale.²⁹

242-245. Duhet thënë se veçanërisht në Egjipt, kishte komunitete shqiptarësh dhe grekësh që vepronin në shoqata të përbashkëta, ku me krijimin e shtetit grek dhe hapjen e konsullatave por edhe me zhvillime të tjera të karakterit historik sikurse ishte një projekt për një shtet të përbashkët, tentativë e cila nuk u realizua, këto shoqata u ndanë, u mbyllën ose u tjetërsuan. Nisur nga afilacioni fetar, veçanërisht në çështjet e emigrimit, shqiptarët zgjidhnin shtetësinë greke pasi u krijonte më shumë avantazhe. Një rast i tillë i një shoqate të përbashkët, ishte Bashkësia Shqiptaro-Greke e Beni Suefit, e cila, sipas autoriteteve konsullore greke, do të mbyllej për t'u bërë vetëm Bashkësia Greke e Beni Suefit. Për më shumë, shih Th. Mitko, *Bleta shqiptare*, vëll. A, f. 83.

²⁷ S. Skendi, *Zgjidhimi kombëtar shqiptar*, f. 152.

²⁸ Frances Trix, *The Sufi Journey of Baba Rexhep*, Philadelphia: University of Pennsylvania of Archaeology and Anthropology, 2009, f. 97-98.

²⁹ S. Çift, *Misir'da Bektaşilik...*, f. 94.

Përfundime

Ndonëse prezenca e shqiptarëve në Egjipt përkon që me vendosjen e sundimit osman në këtë gjeografi, kjo prani mori përmasa të tjera veçanërisht me kalimin e një dinasti me origjinë shqiptare sikurse ishte Muhamed Aliu në krye të këtij vendi, pasardhësit e të cilit do të qeverisnin vendin e faraonëve thuajse për një shekull e gjysmë. Kjo prani shqiptare në drejtimin e këtij vendi, por edhe mobiliteti që ofronte Egjipti që ishte një pikë lidhëse e ekonomisë mesdhetare e botërore bëri që shqiptarë të shumtë të emigronin drejt kësaj gjeografike gjatë gjithë shek. XIX. Veçanërisht gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, shqiptarët e Egjiptit që themeluan këtu shoqëri kulturore e intelektuale, jo vetëm që kontribuan ekonomikisht dhe kulturalisht për vendlindjen, por u kthyen në një strehë të atyre veprimtarëve që përndiqeshin apo internoheshin prej autoriteteve osmane si rrjedhojë e aktivitetit kombëtar. Me nisjen e emigracionit drejt “Kontinentit të Ri”, hapësira e Egjiptit do të shërbente si njëra prej zonave kryesore prej së cilës shqiptarët u nisën për t’u vendosur në Amerikë.